



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 6572/1 prot.

Data: 21, 5, 2024

VENDIM

Nr. 6572/1, Datë 21, 5, 2024

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

- Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Profesionale "Beqir Çela", Durrës
- Akti zyrtar i themelimit/licencimit:** Urdhër nr. 490, datë 27.12.2005, protokolluar me nr. 8936 prot., i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për dhënien e statusit "shkolla të nivelit kombëtar" disa shkollave të mesme teknike, profesionale dhe social-kulturore".
- Organizimi i institucionit:** Shkollë mesme profesionale publike
- Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë mesme profesionale
- Nipti:** K51703523G

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

konstatoj se:

- procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

1. Akreditimin e plotë për kualifikimet profesionale:

- a) "Termohidraulikë" Niveli II në KSHK, Kodi V-II-20
- b) "Instalime hidraulike" Niveli III në KSHK, Kodi V1-III-22
- c) "Instalime të sistemeve ngrohëse – ftohëse" Niveli III në KSHK, Kodi V2-III-22
- d) "Termohidraulikë" Niveli IV në KSHK, Kodi V-IV-23

Në përputhje me propozimin përkatës nr. 177/9, datë 08.11.2023 ardhur nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):

2. Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

